



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.351/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova- kryesuese, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë ka paraqitur ankesë kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 06.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pa bazuar ankesa e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Anr.351/2025 e datës 04.02.2025, paraqitur ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Më datë 04.02.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.351/2025, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës PDK, në të pretendohet se më datë 02 shkurt 2025, kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, aktualisht Kryeministër i Republikës së Kosovës, në tubimin e mbajtur në Komunën e Lipjanit, në fjalimin e mbajtur në këtë tubim, ndër të tjerash deklaroi:vetëm ata të cilët nuk i dojnë familjet e veta dhe fëmijët e vet, ata mujn mos me votu për Vetëvendosjen e me votu për veti. Po nëse i dojnë familjet e veta, nëse i dojnë fëmijët e vet, nëse i dojnë prind e vet, prapë edhe ata duhet me votu për Vetëvendosjen, se veç na kemi program për këto kategori shoqërore që i kanë nevojat më të mëdha, e kanë pas historikisht kontributin më të lartë për shtetin e për kobin tonë".

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur : CD me Përmbajtje të videoincizimit të fjalimit në tubimin.

Më datë 05.02.2025, PZAP-i, e njoftoi Subjektin Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) për ankesën e paraqitur ndaj tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje më datë 05.02.2025 në ora 18:30. Mirëpo në afatin e paraparë Subjekti Politik LVV, nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

Ankesa është e pa bazuar

Paneli, pas shikimit të video incizimit të ofruar si provë materiale e cila është publikuar shihet kandidati për kryeministër nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, aktualisht Kryeministër i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, në fjalimin e mbajtur në tubimin në Komunën e Lipjanit, ku ndër të tjerash deklaroi:*vetëm ata të cilët nuk i dojnë familjet e veta dhe fëmijët e vet, ata mujn mos me votu për Vetëvendosjen e me votu për veti. Po nëse i dojnë familjet e veta, nëse i dojnë fëmijët e vet, nëse i dojnë prind e vet, prapë edhe ata duhet me votu për Vetëvendosjen, se veç na kemi program për këto kategori shoqërore që i kanë nevojat më të mëdha, e kanë pas historikisht kontributin më të lartë për shtetin e për kobin tonë*".

Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me në fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 34 pika 1.11 e LZP përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokoj, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtjen kundrejt tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë. Në fjalimi i lartë cituar, të ofruar si provë, paneli konstaton se përdorur gjuhë e urrejtjes, siç përcakton kjo dispozit ligjore

Andaj Paneli bazuar provat e ofruara ka arritur në përfundim se gjatë mbajtjes së fushatës zgjedhore në këtë rast kandidati për kryeministër nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, aktualisht Kryeministër i Republikës së Kosovës, Albin Kurti nuk ka përdorur gjuhën që bie në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11 e LZP.

Nga arsyet e cekura u vendos si në dispozitiv.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 351/2025 më datë 06.02.2025

Kryesuese e Panelit
Violeta Husaj Rugova

ëshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykata Supreme të Kosovës, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.